



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2021:145492

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05233436

C.nr.5551/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. K nga Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh. B, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale për Arsim me seli në Obiliq, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore në punë, vlera e objektit të kontestit 2,230.00 euro, jashtë seancës, me datë 24.01.2024 mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET PJESRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A. K nga Obiliqi, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, A. K në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 21.11.2023, për 1115 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 2,230.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (me datën 06.07.2021) e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve nën kërcënim të pasojave të përmbarimit.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit me ta cilën ka kërkuar kompensimin e shujtave ditore për 220 ditë pune në shumë prej 440.00 për periudhën e njëjtë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi A. K nga Obiliqi, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 06.07.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Obiliq, për kompensimin e shujtave ditore. Paditësi, në padi, ndër të tjera ka theksuar se është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe atë në pozitën e punëtorit teknik në SH.F.M.U “P...” në Obiliq, dhe se paditësi ka 1335 ditë pune në këtë shkollë, andaj edhe i ka plotësuar kushtet për realizimin kompensimin e shujtave ditore ashtu siç

parashihet me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e hyrë në fuqi me datë 18.04.2017. Tutje ka theksuar se e paditura nuk e ka paguar shujtën për ushqim ditor, ashtu siç përcaktohet në kontratën në fjalë.

Përmes parashtresës së dorëzuar në gjykatë me datë 29.11.2023, kërkesën e padisë e ka precizuar ashtu që nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit A. K në emër të shujtës ditore për ushqim për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 21.11.2022, për 1335 ditët e pranisë në punë, t'ia kompensojë shumën prej 2,270.00 euro, me kamatë 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri te pagesa përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, parashtresës për precizimin e padisë në shumë prej 104.00 si dhe taksës gjyqësore në shumë prej 21.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi të dorëzuar në gjykatë me datë 27.11.2023, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paditësit i takon e drejta për kompensimin e shujtave ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 17.04.2017, mirëpo e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, ku në nenin 37 të së cilës është përcaktuar se *“Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe ti respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”*, e që rrjedhimisht e paditura nuk është përgjegjëse për të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ka obligim e as të drejtë të bëjë ndarje buxhetore për këto lloje të kompensimit, për shkak se me nenin 46 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017, obligim për sigurimin e mjeteve që kanë implikime financiare nga kjo kontratë e ka MASHT-it, SBASHK-ut, Ministria e Financave e jo komuna e Obiliqit. Po ashtu edhe me neni 90, paragrafi 5 i Ligjit të Punës, ka përcaktuar se *“Marrëveshja kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*, dhe se e paditura nuk ka marrë përsipër detyrimet e kësaj kontrate dhe se primare për të ka qenë kryerja e obligimeve për pagat jubilarë dhe shujtat e mësimdhënësve. Andaj, bazuar në të dhënat si më lart, i ka propozuar gjykatës, që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i kërkuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimin të përgjigjes në padi, dhe parashtresës së datës 29.11.2023, mbi precizimin e padisë, e të cilën palës së paditur gjykata ia ka dorëzuar me datë 06.12.2023, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit dhe mungesës së përgjegjësisë së të njëjtës për përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe faktin se e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësi A. K është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës së punës me numër protokollit 111-IX/2020 të datës 01.09.2020. Gjykata përmes vërtetimit për ditët e prezencës në punë me numër të protokollit 965/01, i datës 10.06.2021 gjeti se paditësi për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 31.05.2021 ka qenë 785 ditë prezentë në punë, ndërsa me vërtetimin me numër protokollit 178/01 i datës

17.11.2023 gjeti se paditësi për periudhën kohore nga data 01.06.2021 deri me datë 21.11.2022 ka qenë 330 ditë prezentë në punë, gjithsej paditësi për periudhën nga data 18.04.2017 e deri më 21.11.2022 ka qenë prezentë 1115 ditë punë.

Nga provat e cekura si më lartë, gjykata gjeti se paditësi nuk ka pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i datës 10.06.2021, me numër protokolli 965/21, gjykata gjen se paditësi A. K ka qenë prezentë në punë 785 ditë, ndërsa nga vërtetimi i datës 17.11.2023, me numër protokolli 178/01 gjykata gjeti se paditësi ka qenë prezentë në punë 330 ditë, gjithsej 1115 ditë pune për përdhën si në precizim të kërkesëpadsisë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditësit i ka shumëzuar me nga 2 euro, rrjedhimisht duke i njohur shumën si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditësit në harmoni me nenin 35 par.7, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”*.

Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që refuzoi pjesën e kërkesëpadsisë së paditësit për 220 ditë pune, në shumë prej 440.00 euro. Gjykata bazuar në provat e dorëzuara nga paditësi gjeti se i njëjti për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 21.11.2022, ka gjithsej 1115 ditë pune të cilat nëse shumëzohen me 2 euro del shuma si në pikën –I- të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi, e jo 1335 ditë pune siç gabimisht ka pretenduar paditësi në parashtresën për precizimin e padsisë. Andaj meqenëse paditësi për 220 ditë pune siç pretendon në parashtresën për precizim të padsisë, nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë, gjykata e refuzoi këtë pjesë të kërkesëpadsisë, vendosje kjo në mbështetje të nenit 399 të LPK-së në të cilin është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për ushqime gjatë punës, i njëjti është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi e ka rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili ka përcaktuar se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën si në pikën -I - të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se nuk kanë linjë buxhetore të ndarë për pagesën e shujtave dhe shpenzimeve të transporti i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësi në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e linjës së veçantë buxhetore të të paditurës, si dhe pretendimi se e njëjta nuk është përgjegjëse për faktin se nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 23.07.2021.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 të LPK - së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumë prej 124.00 euro i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104, taksës për padi në shumë prej 20.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka qenë jo e plotë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.5551/2021, datë 24.01.2024

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*